



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri (JR) 15/2018  
Nr. 1.2/2... regj.

Tiranë më 11.12.2018

**SHPALLJE**

**E**

**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e mërkurë, datë 09.01.2019, ora 10:00, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja me nr. regjistri (JR)15/2018, datë 11.09.2018, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 34, datë 11.07.2018.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesues i Trupit Gjykses</b>	<b>Sokol Çomo</b>
<b>Relatore e Çështjes</b>	<b>Albana Shtylla</b>
<b>Gjyqtar</b>	<b>Ardian Hajdari</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Natasha Mulaj</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**RELATORE E ÇËSHTJES**

**GJYQTARE**

**Albana Shtylla**

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTAR**

**Sokol Çomo**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, [www.kpa.al](http://www.kpa.al), e-mail: [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al)

